



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200611/4

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Kavajë.*

Drejtuar: Drejtues i parë Lorenc PANGANIKA
Drejtori i DVP-së Tiranë

TIRANË

Kryekomisar Emiljano PASHAJ
Shef i Komisariatit të Policisë Kavajë

KAVAJË

I nderuar z.Panganika,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 i ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Kavajë.

Inspektimi u krye në datën 29.04.2022, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit të inspektimit ishin z.Besnik Deda dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të

Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrrojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Kavajë, z.Emiljano Pashaj, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në takim me drejtuesit e komisarariatit, grupi i inspektimit mori një informacion në lidhje me kushtet infrastrukturore të krijuara në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, masat e marra për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar nga punonjësit e policisë në mjediset e këtij komisaritati, si dhe verifikoi zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit i shoqëruar nga specialistët e rendit në këtë komisaritat, vizitoi ambientet e privimit të lirisë së personit, kontrolloi regjistrat, dokumentacionin dhe librat e shërbimit ku evidentohen të dhënat dhe dinamika ditore me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, si dhe, në mungesë të personave në këto ambiente, zhvilloi intervista me punonjësit e policisë në lidhje me procedurat që ndiqen për garantimin e të drejtave të shtetasve kur ata hyjnë në mjediset e këtij komisaritati.

Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi zyrat e punonjësve të policisë që kryenin veprime proceduriale me personat e shoqëruar apo të dyshuar për vepra penale, si dhe administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

- ✓ Ishte plotësuar rekomandimi, për **transferimin e personave të ndaluar me vendim të formës së prerë të gjykatave kompetente** nga ambientet e komisarariatit për një nga IEVP, brenda 48 orëve nga koha e njoftimit të Komisarariatit të Policisë Kavajë dhe miratimit nga DPB-ja.
- ✓ Ishte plotësuar rekomandimi, **për instalimin e kamerave të sigurisë** për mbajtjen në vëzhgim të ambientit të shoqërimit dhe të sigurisë dhe në dhomën e marrjes në pyetje apo intervistimin e personave me masë sigurie “arrest me burg”.

¹ Shkresë nr.K4/I13-2 prot., datë 26.07.2021 dërgohen “Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Kavajë”.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk ishin realizuar disa nga rekomandimet referuar më poshtë vijon:

- ✓ Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin e një **dhome më vehte për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar**, të dyshuar për vepra penale, para se ata të kalojnë në dhomat e sigurisë.
- ✓ Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin e “**Njësisë për intervistimin e personave të mitur**” në konflikt me ligjin, si një mjedis i veçantë.
- ✓ Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin në ambientin e sigurisë **të dhomës së mjekut**, për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku i DVP Tiranë dhe plotësimin në kohë të dokumentacionit mjeksor (regjistrin dhe kartelat mjekësore).
- ✓ Nuk ishte plotësuar rekomandimi, **për informimin dhe dhënien e kartës me të drejtat** e personave të shoqëruar, që në momentin e hyrjes së tyre në mjediset e komisariatit të policisë.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e policisë të komisariatit me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë vizitës inspektuese që u zhvillua në ambientet e këtij komisariati.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Kavajë, mjedisi i shoqërimit përgjithësisht ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit².

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës së komisariatit dhe kishte 3(tre) dhoma shoqërimi. Dhomat e shoqërimit ishin të ndara më vehte për personat e rritur, gra dhe të mitur.

Parametrat teknikë të dhomave të shoqërimit ishin të tilla që mundësonin sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për mbajtjen dhe qëndrimin ulur në kushte normale të të shoqëruarve. Përmasat e dhomave janë 4x4m dhe kapaciteti fizik është për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 10 persona të shoqëruar (2-3 persona në dhomë).

Dhomat e shoqërimit ishin të kompletuara me orënditë e nevojshme si tavolinë pune dhe karrige (me këmbë të fiksuara në dysHEME), për qëndrimin ulur të të shoqëruarve. Dyert e

² *Kreu VII, pika 4 “Kushtet e mbajtjes dhe siguria për personat e shoqëruar” e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

dhomave mbylleshin me çelës nga jashtë, i cili mbahej nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Dritaret e dhomave të shoqërimit kishin përmasa të tilla të cilat mundësonin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Në pjesën e jashtme ato ishin të siguruara me rrjetë të hollë hekuri, për arsye sigurie të personave që qëndrojnë në këto ambiente. Dhomat kishin dhe ndriçim artificial, që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Mjediset dhe dhomat e shoqërimit **nuk** ishin të pastra nga ana higjiene-sanitare. Ato kishin nevojë për pastrim dhe lysterje, pasi muret e brendshme **nuk** ishin të mirëmbajtura.

Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodhej një tualet i përbashkët për meshkuj dhe gra, e kompletuar me lavaman me rubinet dhe nyje hidrosanitare, si dhe kishte furnizim me ujë të rrjedhshëm.

Grupi i inspektimit evidentoi se, në ambientin e shoqërimit **mungojnë ambientet e intervistimit** për personat e rritur dhe për të mitur. Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, marrja në pyetje dhe intervistimi i të shoqëruarve (të rritur dhe të mitur), kryhet në zyrat e punës të punonjësve të policisë, ambiente të cilat **nuk** janë të monitoruara me sistemin audio-viziv të kamerave të sigurisë.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit, ishte instaluar vetëm një kamera sigurie për mbajtjen në vëzhgim të këtyre mjediseve, pamjet e të cilës monitoroheshin nëpërmjet një monitori të vendosur në sallën operative të komisariatit nga punonjësi i shërbimit të policisë.

Posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë ishin të vendosur në korridorin e këtij ambienti dhe jo brenda në dhomat e shoqërimit, me qëllimin që ato të jenë të aksesueshme për tu lexuar nga të shoqëruarit.

Në dhomat e shoqërimit, si dhe në zyrat e punonjësve të policisë, grupi i inspektimit nuk gjeti sende apo mjete që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në momentin e kryerjes së inspektimit, në mjedisin e shoqërimit nuk ndodhej asnjë person i shoqëruar. Për periudhën Janar–Prill 2022 në ambientet e këtij komisariati ishin shoqëruar **gjithsej 178 persona**, nga të cilët 166 persona në moshë madhore, 4 gra dhe 8 të mitur në konflikt me ligjin. Të dhënat e tyre ishin të evidentuara në regjistrat respektivë për të shoqëruarit e rritur dhe të mitur.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarariat e Policisë Kavajë, ambienti i sigurisë në përgjithësi ishte i ndërtuar sipas normave, kushteve dhe standardeve që përcaktohen në procedurën standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019³.

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të ndërtesës të komisarariatit, me kushte që garantojnë ruajtjen dhe sigurinë e personave me masë sigurie “arrest me burg”. Ambienti kishte 3(tre) dhoma sigurie të ndara më vehte për burra, gra dhe të mitur⁴. Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë referuar sipërfaqes, hapësirës së dhomave dhe numrit të shtretërve është për akomodimin e 3 personave të arrestuar/ndaluar.

Dhomat e sigurisë i plotësojnë pjesërisht kushtet dhe kriteret për ndërtimin e tyre, sipas normave dhe parametrave teknikë të përcaktuar në procedurën standarde. Ato kanë përmasa 4x3m, të ndara në dy ambiente nga një skarë hekuri me derë në mes të saj, në dhomën e qëndrimit dhe në paradhomë.

Në çdo dhomë kishte krevat për fjetje dhe një nyje hidrosanitare, si dhe ishte e kompletuar me orënditë dhe materialet e nevojshme për qëndrim dhe jetesë normale si krevat për fjetje, batanije dhe jastëk. Në dhomat e sigurisë ishin të montuara në mur buton/zile për të kontaktuar me punonjësin e shërbimit në rast nevojë, por ato **nuk** punonin dhe ishin jashtë funksionit⁵.

Në ambientin e paradhomës, nga inspektimi u evidentua se aty ndodhej një lavaman me rubinet për komandimin e ujit, që shërben për mbajtjen e pastërtisë personale, si dhe depozitë uji për WC-në. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm i ambienteve të komisarariatit, kryhej nga ujësjellsi i qytetit Kavajë.

U evidentua gjithashtu, se në ambientin e paradhomës **nuk** kishte të montuar pajisje apo sisteme për ngrohje gjatë dimrit. Ngrohja, sipas stinës dhe temperaturave, kryhej me pajisje elektrike që administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Grupi i inspektimit, konstatoi një defekt teknik në ndërtimin e skarës së hekurit që ndan dhomën me ambientin e paradhomës. Mbi lartësinë e derës që lidh këto ambiente, në pozicion horizontal **ndodhej një shufër hekuri**, e cila mban të fiksuar shufrat e hekurit të vendosura vertikalisht nga dyshemeja në tavanin e dhomës. Vendosja e shufrës metalike në pozicion horizontal, mbi parametrat teknik të përcaktuar në procedurën standarde,

³ Kreu VIII, pika 3/d.1 “Kriteret për ndërtimin e dhomave të sigurisë” e procedurës standarde.

⁴ Kreu VIII, pika 3.3 e procedurës standarde ku thuhet shprehimisht se: “Normat dhe parametrat teknike, jetësore e të sigurisë së dhomave për një të arrestuar/ndaluar janë: sipërfaqe të përgjithshme jo më pak se 10 metër katror, e cila ndahet në ambient qëndrimi (dhoma) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Lartësia e këtyre ambienteve është jo më pak se 2.5 m”.

⁵ Kreu VIII, pika 4/c “Rregullat për ndërtimin e funksionimin e ambientit të qëndrimit, nëdhomën e sigurisë”.

përbën shkak ose premisë për cënimin e sigurisë së jetës të personave që ndodhen në këto ambiente.

Konkretisht, në kriteret për ndërtimin e dhomave të sigurisë të procedurës standarde, thuhet shprehimisht se: *“Në rastet kur lartësia e ambientit është më shumë se 2.5 m për të përforcuar e rritur sigurinë e elementëve të zgarës së hekurit ndarëse vendosen: d.1Një shufër metalike në pozicion horizontal në një lartësi **jo më shumë se 60 cm**, ose ndërtohet një mur nga dyshemeja me **një lartësi 50 cm**, në të cilin të jenë të fiksuar të gjitha shufrat metalike vertikale”*.

Pikërisht, ky element shërbeu si mjet për vdekjen shtetasit Ilvi Agim Meta, 31 vjeç, lindur dhe banues në Kavajë, në mbrëmjen e datës 04.05.2022, në dhomat e sigurisë në Komisarariat e Policisë në Kavajë, në rrethana ende të paqarta. Lidhur me zbardhjen e kësaj ngjarje të rëndë dhe sqarimin e rrethanave për arsyet dhe shkakun e vetëvrasjes të këtij shtetasi, institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar me iniciativë procedurat e një hetimi të pavarur administrativ. Në përfundim të këtij hetimi, institucioni ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju bëjë me dije mbi rezultatet e këtij hetimi, me përgjegjësitë konkrete të zinxhirit drejtues të komisarariatit lidhur me këtë ngjarje të rëndë.

Ndërtimi dhe funksionimi i dhomave të sigurisë, krahas normave dhe parametrave të përcaktuara në procedurat standarde, duhet të plotësojnë detyrimisht edhe normat, parametrat dhe standardet e vendeve të BE-së. Konventa “Për parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore e degraduese”, përcakton shprehimisht se: *“Dhomat e sigurisë duhet të sigurojnë kushte për: **“Sigurimin e jetës dhe të shëndetit të personave nga veprimet e kundërligjshme të personave të tretë, si dhe për të parandaluar largimin apo arratisjet me forcë nga këto ambiente”***. Ndaj ngjarja e rëndë me pasojë vdekjen e një shtetasi, krahas rezultateve që do të nxjerrë hetimi i pavarur, rezulton se paraprakisht, ka për bazë shkeljen e parametrave teknikë për ndërtimin e dhomave të sigurisë të miratuar në procedurën standarde, si dhe të akteve ndërkombëtare për këtë qëllim.

Dhomat e sigurisë kishin dritare të cilat mundësojnë ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Në dhomën e qëndrimit nuk kishte të instaluar pajisje ndriçimi dhe asnjë instalim tjetër elektrik, hidraulik apo ngrohje, tuba apo hekura të dala jashtë murit apo dyshemesë, të cilat të mund të cënojnë elementët e sigurisë për personat e arrestuar/ndaluar. Ndërkohë, për ndriçimin e dhomave të sigurisë kishte edhe gjenerator si burim rezervë energjie.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej një telefon fiks dhe citofon, për të mundësuar kontaktin e punonjësit të policisë të shërbimit me sallën operative të komisarariatit, në rast emergjence.

Në fundin e korridorit në ambientin e sigurisë, ndodhej dhoma për marrjen në pyetje nga përfaqësuesi i organit të prokurorisë të personave të ndaluar/arrestuar, e cila shërbente njëkohësisht edhe për takime me avokatin mbrojtës. Dhoma ishte e pajisur me tavolinë

pune dhe karrige prej druri me këmbë të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme, për qëndrimin ulur të përfaqësuesit të organit të akuzës, avokatit mbrojtës dhe personit të ndaluar/arrestuar. Ajo monitorohej nga një kamera sigurie, me qëllimin për të vëzhguar veprimet e OPGJ me personat e ndaluar/arrestuar gjatë marrjes në pyetje, apo kundërveprimet e paligjshme të këtyre personave ndaj punonjësve të policisë apo përfaqësuesit të organit të akuzës.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, e cila shërbente njëkohësisht edhe si dhomë e mjekut të DVP Tiranë për kryerjen e vizitave mjeksore. Ajo ishte e pajisur me orenditë e nevojshme si tavolinë pune, karrige, krevat, rafte për mbajtjen e dokumentacionit dhe kartelave mjeksore. Referuar procedurave standarde, këto ambiente kanë funksione të ndryshme ndaj ato duhet të jenë të ndara më vehte nga njëra tjetra⁶.

Konkretisht, dhoma e mjekut nuk plotëson kushtet higjieno-sanitare për kryerjen e vizitave mjeksore, pasi ky ambient duhet të sigurojë kushte të plota ajrimi, ndriçimi dhe ngrohje, si dhe të garantojë pavarësinë e detyrës së mjekut gjatë kontrollit shëndetësor të personave të ndaluar/arrestuar.

Në momentin e inspektimit, nuk ndodhej asnjë person me masë sigurie në këto ambiente. Nga kqyrja e regjistrit, për periudhën janar–prill 2022 në dhomat e sigurisë ishin mbajtur dhe siguruar 70 persona në cilësinë e të arrestuarit apo të ndaluarit, nga të cilët asnjëri prej tyre nuk ishte grua apo i mitur. Nga regjistri u evidentua, se për këtë periudhë nuk ka patur situata të mbipopullimit në dhomat e sigurisë të komisariatit.

Ambienti i sigurisë nuk kishte sistem ngrohje qendrore, por komisariati kishte marrë masa për sigurimin e pajisjeve elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në korridorin e dhomave të sigurisë ndodhej ambienti i tualetit dhe dushit për larjen e trupit të personave të ndaluar/arrestuar. Ky ambient ishte i kompletuar me depozitën e ujit të ngrohtë, pajisjet e dushit dhe me nyjen hidrosanitare. Nga verifikimi, ambienti kishte furnizim me ujë të rrjedhshëm dhe ujë të ngrohtë për larjen e trupit.

Ambienti i sigurisë, në pjesën e brendshme, monitorohej nga 2 kamera të vendosura në dy anët e koridorit, të cilat ishin në gjendje pune. Pamjet filmike monitoroheshin nga punonjësi i policisë në sallën operative. Afati i ruajtjes të pamjeve filmike ishte 15 ditë, ndërsa administrimi i tyre kryhej nga sektori i IT-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

⁶ *Kreu VIII, Pika 8 “Rregullat e sigurisë dhe pajisjet që mbahen në dhomat e vizitave mjeksore”.*

Në korridorin e ambientit të sigurisë, ishin të afishuara posterat me të drejtat që gëzojnë personat e ndaluar/arrestuar, një kopje e të cilës ndodhej edhe në setin e dokumenteve që mbaheshin nga personat e arrestuar/ndaluar.

Ambienti dhe dhomat e sigurisë, përgjithësisht ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Ato kishin nevojë për mirëmbajtje dhe dizifektime të vazhdueshme.

Gjatë inspektimit, në ambientin e sigurisë nuk u gjetën sende që shkaktojnë/eksponojnë dhunë psikologjike tek të ndaluarit/arrestuarit.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i tyre

Në Komisarriatin e Policisë Kavajë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, sipas procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Personat e shoqëruar në organin e policies, sipas shënimeve në regjistër, ishin sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Të shoqëruarit, pasi regjistroheshin në regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit, shoqëroheshin për të qëndruar në dhomat e shoqërimit sipas ndarjes së tyre. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, rubrikat ishin të plotësuar nga punonjësit e zyrës së informacionit dhe ishte i sekretuar. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë.

Të dhënat për personat që akomodoheshin në ambientet e sigurisë të këtij komisarriati, evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ndodhej në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë dhe ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij, nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Nga kqyrja e regjistrave rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, në procesverbalin e përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore, ora e arrestimit në flagrancë të personave, përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në ambientin e sigurisë së këtij komisarriati ndodhej i gjithë dokumentacioni i cili administrohej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, sipas përcaktimeve në procedurën standarde⁷.

Grupi i inspektimit u ndal në veçanti te regjistri për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të ndaluar/arrestuar. Ky regjistër ishte hapur sipas kërkesave të nenit 115, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për vitin 2022 **nuk** ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga shtetasit e ndaluar/arrestuar.

⁷ *Kreu XI, pika 1 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe të shoqëruarve në ambientet e policisë

Në kohën e inspektimit në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë të Komisaritit të Policisë Kavajë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar.

Nga verifikimi i regjistrave, nuk u konstatuan pretendime të shtetasve për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike.

Të ndaluarit trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë me shërbimin katering, sipas normave për trajtimin me ushqim, të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr.432, datë 10.03.2008, të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i fashikujve, rezultoi se personat e ndaluar/arrestuar ishin të pajisur nga oficerët e policisë gjyqësore me kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit ose kopje e vendimit të formës së prerë të gjykatës, kopje e procesverbalit të kontrollit personal, si dhe kopje e kartës me të drejtat e tyre.

Nga intervista me punonjësit e policisë, u informuam se kopja e kartës me të drejtat e personave me masë sigurie u jepej nga oficerët e policisë gjyqësore, në momentin e komunikimit të masës të sigurisë: “arrest me burg”.

Ndërsa, personave në cilësinë e të shoqëruarve, nga informacioni i punonjësve të policisë në zyrën e informacionit u evidentua se, **nuk** jepej karta me të drejtat e tyre, që në momentin e hyrjes në mjedisin e këtij komisariati.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjentë, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Gjatë inspektimit, u konstatua në mënyrë të përsëritur se vizitat mjekësore të personave në ambientin e sigurisë, për shkak të largësisë, **nuk** kryheshin brenda afatit 12 orë nga momenti i hyrjes tyre në dhomat e sigurisë nga mjeku/ndihmësmjeku i DVP Tiranë. Nga verifikimi i regjistrave të vizitave mjekësore, rezultoi se dhe shënimet në kartelat mjekësore plotëheshin formalisht nga mjeku i DVP-së. Nga informacioni i përgjegjësit të dhomave të sigurisë, personat me masë sigurie i dërgonin në urgjencën e Spitalit Kavajë, për kryerjen e vizitave mjekësore.

Ky shqetësim për Komisariatin e Policisë Kavajë, është i përsëritur dhe i evidentuar në të gjitha rekomandimet e inspektimeve të mëparshme të MKPT-së, ku është kërkuar

miratimi i shtesës në organikë të një mjeku/ndihmësmjeku për Komisaratin e Policisë Kavajë me qëllim kryerjen e vizitave mjekësore të personave me msasë sigurie sipas afateve të përcaktuara në procedurën standarte, rekomandim i cili ende nuk është zbatuar⁸.

Grupi i inspektimit, u ndal te procedurat që ndiqen nga punonjësit e policisë në rastet e shoqërimit për në mjediset e policisë të personave të mitur. Lidhur me këtë çështje, në komisaratin e Policisë Kavajë, ishte hapur një regjistër i veçantë për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin, sipas rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ndërkohë, procedura e marrjes në pyetje dhe intervistimi i të miturve, kryhej në prezencë të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës dhe psikologut. Psikologu sigurohej nga Bashkia Kavajë dhe nga shkolla e mesme e qytetit Kavajë. Në raste specifike për nevoja të hetimit, asistonte edhe psikologjia në organikë të DVP-së Tiranë. Avokatët mbrojtës siguroheshin nga lista e miratuar nga organi i prokurorisë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, por të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Kavajë, punonjësit e policisë i kryenin veprimet procedurale me të shoqëruarit në zyrat e punës së tyre, në mungesë të një dhome të veçantë, e cila duhet të jetë e pajisur me orënditë e nevojshme si tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të të shoqëruarve dhe punonjësve të policisë⁹. Ndërkohë, zyrat e punonjësve të policisë, **nuk** ishin të monitoruara me sistemin e kamerave të sigurisë.

Në ambientin e sigurisë ndodhej një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve nga përfaqësuesi i organit të akuzës, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takime me avokatët mbrojtës. Ky ambient ishte i monitoruar me kamera sigurie, për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve procedurale që kryejnë oficerët e policisë gjyqësore me personat e arrestuar.

Sistemi i kamerave të sigurisë të komisarariatit, ishte funksional dhe monitorohej nga punonjësi i policisë në sallën operative të komisarariatit. Nisur nga ngjarja e rëndë që ndodhi në datë 04.05.2022 me pasojë vdekjen e shtetasit I.M, është e domosdoshme të shtohet numri i kamerave të sigurisë në ambientet e brendshme të komisarariatit, si dhe të përmirësohet cilësia e pamjeve të kamerave për kqyrjen e veprimeve që kryhen me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, pasi nga administrimi i pamjeve filmike që bëri institucioni i Avokatit të Popullit menjëherë pas kësaj ngjarje, rezultoi se jo të

⁸ *Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".*

⁹ *Kreu VII, pika 4/d e procedurës standarde për shoqërimin ku thuhet se "Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura pajisje e orëndi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si; tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme."*

gjitha ambientet mbuloheshin nën vëzhgimin e kamerave dhe cilësia e pamjeve filmike ishte e dobët.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit¹⁰.

Sikurse e theksuam, në Komisaratin e Policisë Kavajë, mungonte mjedisi për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin, ku sipas Kodit për Drejtësi Penale për të Mitur dhe procedurave standarde, duhet të jetë një ambient i veçantë dhe i pajisur me kushte të përshtatshme pune dhe qëndrimi. Dhe në këtë rast, MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim i panevojshëm i fëmijëve.

Nga monitorimi që ju bë zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe intervistat me punonjësit e policisë të këtij komisarati, u konstatua se, personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar ishin të informuar se, në pamundësi financiare për të pajtuar një avokat mbrojtës privat, legjislacioni parashikon se mundet të kërkonin ndihmë juridike për t'ju ofruar një avokat kryesisht. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të miratuar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut.

Në këtë komisarati, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VIII, pika a.3.4 të procedurës standarde për shoqërimin në mjediset e policisë, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Nga

¹⁰ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

inspektimi, rezultoi gjithashtu se, për personat e shoqëruar mbahej nga punonjësi i policisë një procesverbal tip i emërtuar: “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”.

Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, procesverbalin e dorëzimit të sendeve personale dhe letra për njohjen me të drejtat që gëzojnë këta persona, gjatë qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Në rastin e ndalim/arrestimit të personave me shtetasi të huaj, ju ofrohet dhënia e deklaratës ku parashikohen të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar e përkthyer në 6 gjuhë të huaj.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”.

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa të menjëhershme, për verifikimin e të gjithë elementëve të sigurisë që duhet të plotësojnë dhomat e sigurisë, përshtatjen e tyre sipas normave dhe parametrave teknikë të përcaktuar në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare, me qëllim garantimin e sigurisë së jetës, të shëndetit dhe sigurisë fizike të personave me masë sigurie.
2. Të merren masa të nevojshme, për vënien sa më parë në funksionim të butonit/zileve të montuara në muret e dhomave të sigurisë, për njoftimin e personave të ndaluar apo të arrestuar të punonjësve të shërbimit të policies, në rast nevojë.
3. Të merren masa për sigurimin e ngrohjes në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, në varësi të stinës dhe temperaturave.
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një mjedisi të veçantë për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin, i cili të jetë i plotësuar me materiale

informuese dhe i pajisur me orenditë e nevojshme si tavolina pune për punonjësit e policisë dhe ndenjësë për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor, psikologut dhe avokatit mbrojtës.

5. Marrjen e masave të menjëhershme organizative, për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku i DVP-së Tiranë brenda 12 orëve të ndalimit/ arrestimit të personave, si dhe plotësimi në kohë i dokumentacionit mjekësor (regjistri dhe kartelat mjekësore) për secilin person të ndaluar/arrestuar. Të bëhet një hetim i thelluar për arsyet e moszbatimit të këtij rekomandimi të përsëritur të institucionit të Avokatit të Popullit dhe të nxirren përgjegjësitë konkrete administrative dhe disiplinore ndaj personave që nuk e kanë ushtruar këtë detyrim në afatet kohore të përcaktuara sipas procedurës standarde.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin në ambientin e sigurisë të dhomës me vehte të mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe paisjen e saj me orenditë e nevojshme dhe me medikamente mjekësore për nevojat urgjente.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës me të drejtat personave të shoqëruar që në momentin e shoqërimit të tyre në mjediset e komisariatit të policisë, si dhe vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar brenda në dhomat e shoqërimit, me qëllim që ato të jenë të aksesueshme nga këta persona, pasi nuk është efektive nëse janë të vendosura vetëm në korridorin e ambientit të shoqërimit.
8. Marrjen e masave të domosdoshme për shtimin e kamerave të sigurisë në ambientet e brendshme të komisariatit, si dhe të përmirësohet cilësia e pamjeve të kamerave për kqyrjen e plotë të veprimeve që kryhen me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI